
THE IMPORTANCE OF COMMUNICATION BETWEEN TEACHERS AND STUDENTS IN THE DEVELOPMENT OF COMMUNICATION SKILLS IN FOREIGN LANGUAGES

Aterda Lika

University of Shkodra, Foreign languages faculty, Romanistic departement, alika@unishk.edu.al

Abstract: Communication allows to motivate, involve, organize and solve problems: all indispensable activities in the classroom life. The sharing of information and the comparison of different life experiences are fundamental for the success of the teaching activity. The experience of the teacher, if communicated in the right way, will be received by the student as an aid for his life and chosen as a model to be imitated. The development of communication skills is the nodal point of many approaches and methods of modern language teaching. The communication event has a complex nature and requires the co-construction and negotiation of the meaning by the interlocutors, as well as the consideration of numerous factors, such as the socio-cultural component, the linguistic register and the psychological relationship between the participants. Regardless of the type of approach we intend to use, we believe it is fundamental for both the professor and the student to be able to observe and reflect, to increase the self-awareness of how and why communication takes place in the classroom and to adapt innovative teaching techniques also supported by latest technological developments. Our work tends to show how much communication between teachers and students is effective in the development of communication skills in a foreign language.

Keywords: Communication skills , teacher, students.

RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT MËSUES-NXËNËS NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE KOMUNIKUESE NË GJUHËN E HUAJ

Aterda Lika

University of Shkodra, Foreign languages faculty, Romanistic departement, alika@unishk.edu.al

Nëpërmjet komunikimit bëhen të mundur motivimi, angazhimi, organizimi dhe zgjidhja e problemeve të cilat konsiderohen si aktivitete thelbësore në jetën e klasës. Shkëmbimi i informacionit dhe krahasimi i përvojave të ndryshme të jetës janë kritike për suksesin e veprimtarisë edukative. Përvoja e mesuesit, nëse perçohet nga ai në mënyrën e duhur perceptohet nga nxënësi si ndihmë në kapërcimin e pengesave e mund të përbëjë edhe një model për t'u imituar. Zhvillimi i aftësive të komunikimit është një nga çështjet bazë në qasjet dhe metodat moderne të mësimin të gjuhëve të huaja. Eventi komunikativ paraqet një natyrë komplekse dhe kërkon bashkërendimin dhe negocimin e kuptimit nga ana e bashkëbiseduesit, duke u bazuar në faktorë të ndryshëm, të tillë si aftësia socio-kulturore, regjistri gjuhësor apo marrëdhëniet psikologjike mes pjesëmarrësve. Pavarësisht nga lloji i qasjes në të cilën bazohet mesimdhënia në mendojmë se është e rëndësishme për të dy palet si mesuesin ashtu edhe nxenesin që të dinë të vëzhgojnë dhe të reflektojnë, për t'u ndergjegjesuar për rëndësinë e komunikimit në klasë i cili duhet të pershtatet me teknikat e reja të mesimdhënies mbështetur edhe në zhvillimet e fundit teknologjike.

Qellimi i punimit tone është të tregojmë se si komunikimi ndërmjet mesuesit dhe nxënësit ndikon në zhvillimin e aftësive të komunikimit në gjuhën e huaj.

Fjale kyçe: Aftësite komunikuese, mesuesi, nxenesit

Në ditët e sotme funksioni kryesor i arsimit është të formojë nxënës e studentë jo vetëm me dije në disiplinat e ndryshme, por kryesisht të ndihmojë në zhvillimin e personalitetit të tyre që të jenë të aftë të ndërveprojnë në kushtet e një shoqërie që paraqet zhvillime të vazhdueshme. Të gjithë mesuesit duhet të kenë si qëllim kryesor që mesimdhënien e tyre mos ta kufizojnë brenda kornizave të njohurive që përfshijnë lëndët përkatëse, por të ndihmojnë nxënësit në rritjen dhe formimin e tyre, duke edukuar e duke zhvilluar aftësitë e tyre kritike si dhe duke i pajisur me mjetet e duhura për të qenë të përgjegjshëm dhe të pavarur në zgjedhjet e tyre në të ardhmen. Kjo është sfida e re me të cilën përballlet arsimit në kohën që po jetojmë, ku koncepti i dijes si e pandryshueshme dhe e qëndrueshme duket tashmë i harruar.

Koncepti i dijes është zhvilluar në mijëra drejtime e në kontekstin edukativ të arsimit vërehen ndryshimet e mëdha sociale, kulturore, organizative e komunikative, mjafton të kemi parasysh praninë gjithnjë e më të madhe të teknologjive të informacionit dhe komunikimit, të kulturës, e cila ka marrë forma ekspresive e komunikuese të

reja, të zhvillimeve shkencore e teknologjike, të zhvillimit të situatave jetësore shumëkulturore, shumëgjuhësore etj. (Pellerey 2010).

Për t'u përshtatur me këto zhvillime lind nevoja që të kemi mësues të aftë që të përballen me risitë si dhe të kenë aftësi të cilat mund të fillojnë nga “ reflektimi, profesionalizmi, puna në grupe dhe me projekte, autonomia si dhe përgjegjësitë e shtuara, pedagogjitë e diferencuara, vëmendja ndaj materialeve dhe situatave të të nxënësve, ndjeshmëria ndaj dijes dhe dispozitave të cilat hapin skenarin për një zanat të ri” (Perrenoud 2002, f.9)

Aftësitë që një mësues duhet të zotërojë për ushtrimin e plotë të profesionit mund të përmbliken sipas tre makro-sistemeve:

- a. Aftësitë shkencore
- b. Aftësitë pedagogjike
- c. Aftësitë relacionale dhe komunikuese

Aftësitë shkencore lidhen me përgatitjen kulturore të mësuesit, sipas të cilave mësuesi duhet të jetë i aftë të seleksionojë nga gjithë njohuritë e tij, ato njohuri që duhet të përshtaten me proceset e të nxënësve.

Aftësitë pedagogjike dhe didaktike lidhen me aftësinë e mësuesit për të përshtatur njohuritë që përmban lënda sipas strukturës psikologjike të nxënësve.

Aftësitë relacionale dhe komunikuese nënkuptojnë aftësinë e mësuesit për të realizuar një komunikim efektiv, i cili krijon mundësi për një proces nxënësor më të thjeshtë dhe më efikas. Në këtë rast është përgjegjësi e mësuesit krijimi i marrëdhënieve afektive duke krijuar një klimë pozitive në klasë, duke ngjallur interes dhe besim tek nxënësve, duke ditur të sillen me kolegët, prindërit si dhe duke qenë i aftë të punojë në grup. (Margiotta 1997).

Të gjithë mësuesit duhet të kenë aftësi të komunikimit, të cilat i japin mundësi të komunikimit me nxënësve, bazuar në qasjet e metodologjitë sipas të cilave bëhet sot mësimi i gjuhës së huaj, ku në qendër vihet komunikimi dhe zhvillimi i aftësisë komunikuese, e dinë rëndësinë që ka aftësia komunikuese në përvetësimin e gjuhës. Natyrisht çdo mësues në ushtrimin e aktivitetit të tij personal dëshiron të jetë i suksesshëm në procesin e mësimit duke dhënë maksimumin nga vetja për të arritur rezultatet dhe pritshmëritë e tij e të nxënësve, por jo gjithmonë suksesi është i garantuar. Shpesh herë nxënësve nuk janë aktivë në situatat e ndryshme komunikative që mund të zhvillohen në klasë. Natyrisht lind pyetja. Pse ata shpesh herë duken të stepur apo ngurrojnë të komunikojnë?! Paraqesin vështirësi në asimilimin e njohurive dhe përdorimin e tyre në situatat komunikative apo mos ndoshta ngurrojnë nga pasiguria apo frika e gjykimit negativ nga ana e mësuesit apo kolegëve të tyre?! Përballë kësaj pyetjeje besoj e ka gjendur veten çdo mësues e sipas situatave të caktuara është përpjekur të gjejë përgjigjen ku më së shumti ka fajësuar përgatitjen dhe predispozitën e nxënësve duke anashkaluar vetveten. Nisur edhe nga vëzhgimet e shumta që kam kryer në klasat ku mësohet gjuha italiane jam ndeshur shpeshherë me problematikat e mësipërta.

Që nxënësi të komunikojë e të jetë aktiv në klasë duhet të ketë një mësues që ia lehtëson procesin.

Duke trajtuar një problematikë të tillë është e pamundur të mos citojmë psikologun Thomas Gordon, autor i librit *Teacher Effectiveness Training* (“Trajnimi i mësuesit të efektiv”), i cili propozon disa metodologji të dobishme për t'u përdorur në klasë, në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie efektive ndërmjet mësuesit dhe nxënësve e pse jo edhe ndërmjet nxënësve.

Sipas Gordon ekzistojnë tre teknika themelore të komunikimit të mësuesve që shërbejnë për të ndryshuar sjelljet e papërshtatshme.

1. *Dëgjimi aktiv*, kur mësuesi e dëgjon nxënësin duke mos shprehur mesazhe apo gjykime personale, në mënyrë të tillë që nxënësi të ndihet i pranuar. Në këtë mënyrë ai arrin të zgjidhë vetë problemet e tij.
2. *Mesazhi – Unë*, ose teknika sipas së cilës mësuesi krahason nevojat apo ndjenjat e veta me sjelljet shqetësuese të nxënësve, në mënyrë që ai të kuptojë pasojat e veprimeve të tij dhe ndikimit që kanë tek të tjerët. Kështu një komunikim i gabuar nis me mesazhin –Ti, i cili shpreh një gjykim (“Ti je i çrregullt”) dhe mund të provokojë rebelim tek nxënësi. Një komunikim efektiv realizohet nga mesazhi –Unë (Unë bezdisem kur ...), sepse nuk jep një gjykim për atë që kryen veprimin, por hihet si një mënyrë për të hapur dialogun.
3. *Zgjidhja e konflikteve*, sipas Gordon është një mënyrë që nuk ka të humbur që i bën mësuesit e nxënësve të fitojnë së bashku”, duke kërkuar një zgjidhje të kënaqshme për të dy palët. (Gordon 1975)

Edhe pse kanë kaluar shumë vite nga këto mësimet të Gordonit ato vazhdojnë të jenë aktuale dhe t'i përgjigjen nevojave të nxënësve dhe mësuesve në mbarë botën.

Mësuesit që konsiderohen eficientë duket se kanë karakteristika të përbashkëta pavarësisht faktit nëse ata e zhvillojnë aktivitetin e tyre edukativ në shkollën fillore, të mesme apo në universitet. (Malikow, 2006). Ka disa elementë specifikë të cilët mund të lidhen me një fazë zhvillimi të caktuar të nxënësve, por përgjithësisht elementë të tillë si entuziazmi për punën, respekti dhe ndjeshmëria ndaj nxënësve, metodologjia që vë në qendër nxënësin, aftësia për të propozuar aktivitete didaktike stimuluese si dhe mbështetja e nxënësve në përvetësimin e një autonomie të përshtatshme me moshën, janë të gjithë elementë që përbëjnë një mësimit efikas.

Në këndvështrimin profesional mësuesi dhe mësimdhënësia efikase lidhet pashmangshmërisht me nxënësin, pasi të dy grupet janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e motivimit profesional dhe marrëdhënien ndërpersonale pozitive që duhet të ekzistojë ndërmjet tyre, (Koutrouba, 2012; Malikow, 2006), njohjen e materialeve didaktike (Minor e të t.j., 2002) dhe aftësinë për t'i përdorur në mënyrë të tillë që të përfshihet e gjithë klasa në procesin e nxënies. (Onwengbuzie e të t.j., 2007). Të gjithë këto aspekte mund të përvetësohen nga përvoja në punë, por edhe nga formimi i vazhdueshëm si në fillim ashtu edhe gjatë karrierës profesionale.

Sot zhvillohen shumë kurse përditësimi e trajnime të ndryshme, por është e rëndësishme të vihet në qendër të vëmendjes edhe rëndësia e dimensionit social në këtë proces të zhvillimit profesional. Ndarja e përvojave të përbashkëta duke u bazuar në reflektime e diskutime frytëdhënëse ndërmjet mësuesve mund të ndihmojë në rritjen profesionale të gjithësecilit. Duke u nisur pikërisht nga këto kushte Hofman e Dijkstra (2010) propozonin zhvillimin e një modeli të formimit të mësuesit duke formuar një rrjet përfshirës të të gjithë mësuesve, ku mësuesit më me përvojë mund të ndanin aftësitë dhe njohuritë e tyre me më të rinjtë. Ky model synonte të parashtronte linjat kryesore të rezultateve të këtyre praktikave, për të përcaktuar disa baza teorike që do të ishin të vlefshme në procesin edukativ dhe profesional të mësuesve në përgjithësi.

Në lidhje me profilin profesional të mësuesit të gjuhëve të huaja, edhe politikat evropiane bazohen në konceptin e formimit të vazhdueshëm të mësuesit, sepse mësimi i gjuhëve të huaja sot, e veçanërisht sipas direktivave të Këshillit të Evropës është një detyrë që zgjat gjithë jetën. Sipas Serragiotto edhe vetë klasa përbën një vend që bashkë me mësuesin e nxënësit përcakton vetë procesin e nxënies si dhe krijon kushtet për të mësuar gjuhën.

Mësuesi që të arrijë qëllimin e tij, duhet të jetë i zoti të përdorë një shumëllojshmëri kanalesh komunikimi për të bërë të mundur përfshirjen e të gjithë nxënësve si dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin mësimor në përgjithësi e atë komunikues në veçanti. Për këtë qëllim metodologjia didaktike duhet të përfshijë një shumëllojshmëri teknikash me synim krijimin e një procesi nxëniesje të ndryshëm, fleksibël, të pasur dhe efikas. Edhe përdorimi i pajisjeve teknologjike i mundëson nxënësve të bëhen protagonistë të procesit të dijeve dhe njohurive të tyre. Për të arritur të penetrojë dhe të ngjallë interesin e nxënësve edhe vetë mësuesi duhet të përshtatet me risitë teknologjike për të marrë përfitimet më të mëdha të mundshme në procesin mësimor. Një studim interesant i Dianora Bardi, përfaqësuese e qendrës së studimeve të të mësuarit digjital në Palermo, e përshkruan mësuesin modern si “il docente liquido” (mësuesi lëng), e cili duhet të zbresë nga katedra dhe të mësojë realisht se për çfarë kanë nevojë nxënësit e tij, duke e personalizuar procesin e nxënies e duke u njësuar me nxënësit.

Nëse nxënësit kalojnë më shumë se gjysmën e orëve të studimit të tyre me celular në dorë, sado interesante të jenë tematikat mësimore shihet se mendja e tyre është gjetkë. Në këtë pjesë duhet punuar, jo duke u mbështetur aq tek digjitalizimi sa tek një reformim metodologjik, edukativ e didaktik. Sipas Bardit mësuesi duhet të transformohet e të përshtatet saktësisht siç përshtatet uji në enën në të cilën hidhet. Ai nuk duhet t'u imponojë më nxënësve zgjedhjet e tij metodologjike, por t'i dëgjojë e të diskutojnë bashkarisht për problematika që lidhen me procesin mësimor e jo vetëm. Ky do të ishte edhe çelësi i suksesit edhe për mësuesin e gjuhës së huaj, i cili synon të komunikojë me nxënësit në gjuhën e huaj, sepse komunikimi në gjuhën e huaj duhet të përfshijë situata të ndryshme jetësore meqenëse edhe sipas qasjes komunikative rëndësi të veçantë merr *ndërveprimi*, i cili kryhet duke patur në qendër të vëmendjes nxënësin e nevojat e tij komunikative me qëllim krijimin e një aftësie komunikuese që i lejon atij rrjedhshmëri në shprehjen e situatave të ndryshme gjuhësore. Kjo tipologji e mësimdhënies është mjaft e pëlqyer nga nxënësit, pasi qëllimi e motivimi i çdo nxënësi që mëson një gjuhë është të arrijë ta flasë atë pa sforcime në aktet e ndryshme komunikative, pothuajse në të njëjtën mënyrë si gjuha amtare. Të komunikosh në gjuhë të huaj do të thotë të përdorësh të njëjtat aftësi që përdoren edhe në gjuhën amtare, domethënë aftësi që kanë të bëjnë me të kuptuarin, të shprehurin e interpretimin e koncepteve, mendimeve, ndjenjave, ngjarjeve e opinioneve si në formën e shkruar ashtu edhe në atë të folur, në mënyrë të përshtatshme e krijuese në situata kulturore të ndryshme, në shkollë, punë, në shtëpi e gjatë kohës së lirë. Një nxënës zotëron mirë aftësinë komunikuese kur është në gjendje të zgjedhë “kur duhet të flasë, kur duhet të heshtë, për çfarë duhet të flasë, kujt duhet t'i flasë, kur, ku, në ç'mënyrë”. Nxënësi duhet të zotërojë një aftësi komunikuese të plotë, shumë më të plotë se ajo e mirëfilltë gjuhësore.

Një folës i aftë duhet të dijë ta menaxhojë situatën komunikuese me bashkëbiseduesin e tij, duhet të dijë të improvizojë e të përshtasë diskutimin me qëllimin e bisedës, me njohjen enciklopedike të vetën e të bashkëbiseduesit si dhe me rregullat shoqërore dhe kulturore me të cilat bashkëvepron gjuha. Për të arritur këtë nivel komunikimi roli i mësuesit si bashkëudhëtar është i padiskutueshëm, prandaj themi që mësuesi e humb rolin e tij drejtues brenda klasës për të marrë një rol tjetër atë të keshilluesit e të bashkëbiseduesit e në këtë rast ai impenjohet jo më pak se nxënësi në një punë kërkimore dhe krahasuese që përfshin të dy palët në një projekt të përbashkët.

Sipas një pyetësori me shtrirje të gjerë pyetjes se cili është roli i mësuesit sipas jush, i janë dhënë përgjigje nga më të ndryshmet nga të cilat kemi shkëputur disa të cilat janë më të shpeshta e që nxjerrin në pah figurën se si duhet të jetë mësuesi.

- Mësuesi duhet të dijë të transmetojë tek nxënësi njohuritë dhe përvojat e veta për t'i ndihmuar të rriten nga pikëpamja intelektuale si dhe për t'u bërë të pavarur në të ardhmen.
- Mësuesi duhet ta shoqërojë dhe edukojë nxënësin në rrugëtimin e tij, ta ndihmojë në pasurimin e bagazhit të tij kulturor, të ndihmojë në zhvillimin e tij si individ i lirë, i gatshëm për të zhvilluar potencialin e tij pozitiv në shoqëri.
- Mësuesi duhet të ndihmojë nxënësit të shprehen dhe të japin më të mirën nga vetja duke i stimuluar nëpërmjet metodave e strategjive të ndryshme që përdoren në varësi situatës .
- Mësuesi duhet ta ndihmojë nxënësin në krijimin e identitetit të tij, duke i forcuar besimin në vetvete, të dijë të përçojë interes për lëndën duke e bërë nxënësin pjesë të saj.
- Mësuesi duhet ta mësojë nxënësin të arsyetojë, të tregohet kritik në situata të caktuara, të formojë individin dhe ta përgatisë për një formim që duhet të jetë gjithnjë në rritje.
- Mësuesi duhet të jetë model për nxënësin.
- Detyrë e mësuesit është të lërë shenjë.
- Mësuesi është një urë ndërmjet nxënësit dhe kulturës dhe ka përgjegjësinë, privilegjin, por edhe rrezikun të jetë një urë aq e fortë mbi të cilën të kalojnë gjithë dyshimet, vështirësitë, pasiguritë e nxënësve e megjithatë të vazhdojë të qëndrojë në këmbë.

Të gjithë këto cilësi e paraqesin figurën e mësuesit si atë të një super heroi, por ngarkojnë me përgjegjësi të fortë morale dhe profesionale secilin prej nesh duke na sugjeruar që gjithmonë ka vend për të punuar më shumë e duke mos harruar që në këtë profesion jemi gjithnjë edhe nxënës e gjithnjë të pyesim veten nëse kemi bërë dhe po bëjmë aq sa duhet.

REFERENCA

- [1] Gordon TH. (1975) *Teacher Effectiveness Training* . Gordon training International
- [2] Hofman, R.H., & Dijkstra, B.J. (2010). Effective teacher professionalization in networks? *Teaching and Teacher Education*, 26, 1031–1040.
- [3] Karakas, M. (2013). Prospective elementary teachers' views on their teachers and their effectiveness. *The Qualitative Report*, 18(86), 1–17.
- [4] Koutrouba, K. (2012). A profile of the effective teacher: Greek secondary education teachers' perceptions. *European Journal of Teacher Education*, 35(3), 359–374.
- [5] Larsen, Freeman, Diane. (2000). *Techniques and Principles in language Teaching*. Oxford. Oxford University Press
- [6] Malikow, M. (2006). Effective teacher study. *National Forum of Teacher Education Journal*, 16(3E), 1–9. <http://www.nationalforum.com/Electronic%20Journal%20Volumes/Malikow,%20Max%20Effective%20teacher%20Study.pdf> (ver. 15.07.2016).
- [7] Margiotta U. (1997). *L'insegnante di qualità*. Roma: Armando.
- [8] Minor, L.C., Onwegbuzie, A.J., Witcher, A.E., & James, T.L. (2002). Preservice teachers' educational beliefs and their perceptions of characteristics of effective teachers. *The Journal of Educational Research*, 96(2), 116–127.
- [9] Onwegbuzie, A.J., Witcher, A.E., Collins, K.M., Filer, J.D., Wiedmaier, C.D., & Moore, C.W. (2007). Students' perceptions of characteristics of effective college teachers: a validity study of a teaching evaluation form using a mixed-methods analysis. *American Educational Research Journal*, 44(1), 113–160.
- [10] Pellerey M. (2010). *Competenze, conoscenze, abilità, atteggiamenti*. Roma- Napoli.
- [11] Perrenoud P. (2002), *Dieci competenze per insegnare*. Roma: Anicia.
- [12] Serragiotto, G. (2009) *Sillabo di riferimento per la formazione degli insegnanti di italiano a stranieri*. Università Ca' Foscari Venezia